

KALLEZIM

- KALLEZUES :**
- 1. Emiljano Shullazi**, i biri i Hajdarit, i dtl.24.04.1978, aktualisht i paraburgosur ne IEVP 313, „Jordan Misja“-Regjimi i Posacem i Sigurise se Larte, Tirane.
 - 2. Gilmando Dani**, i biri i Nesim-it, i datelindjes 21.04.1978, aktualisht i paraburgosur ne IEVP 313, „Jordan Misja“ – Regjimi i Posacem i Sigurise se Larte, Tirane.
- TE KALLZUARA :**
- 1. Arta Marku**, ish-Prokurore e Pergjithshme e Perkoheshme e Republikes.
 - 2. Donika Prela**, ish-Drejtuese e Prokurorise se Krimeve te Renda.
- OBJEKTI :**
- Kallezohet ish Prokurorja e Pergjithshme e Perkoheshme **Arta Marku** dhe ish Drejtuesja e Prokurorise se Krimeve te Renda **Donika Prela**, per vepren penale te “*Shperdorimit te detyres*” qe parashikohet nga neni 248 i Kodit Penal.
- BAZA LIGJORE:**
- Nenet **75/a, 280, 283** te Kodit te Procedures Penale dhe neni **248** i Kodit Penal.

Drejtuar:

PROKURORISE SE POSACME KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE ORGANIZUAR

T I R A N E

Z/Znj. Prokuror/e,

Ne, kallzuesit, Emiljano Shullazi dhe Gilmando Dani, jemi duke u gjykuar ne Gjykatën e Posacme te Apelit per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tirane.

Me Urdherat respektive Nr. 253 dhe 255, date 28.07.2020, te Ministrit te Drejtesise, jemi vendosur ne regjimin e posacem te ushtrimit te te drejtave, ne burgun e sigurise se larte prane Institucionit te Ekzekutimit te Vendimeve Penale “Jordan Misja”, Tirane.

Urdherat e Ministrit te Drejtesise, jane ankimuar ne Gjykatën e Posacme Kunder Korrupsionit dhe Krimin te Organizuar, si te kundraligjshem dhe abuzive.

Vendim marrja e Ministrit te Drejtesise buron nga e drejta qe i jepet atij nga ligji nr.108/2018 “Per nje shtese ne Ligjin Nr.8328, date 16.04.1998 “Per te drejttat dhe trajtimin e te denuarve me burgim dhe te te paraburgosurve”, (me ligjin Nr.81/2020, ne daten 25.06.2020, Kuvendi i Shqiperise ka miratuar ligjin e ri “Per te drejttat dhe trajtimin e te denuarve me burgim dhe te te paraburgosurve”, duke shfuqizuar ligjin e vjeter Nr.8328, date 16.04.1998).

Sipas ligjit te kohes kur kane dale Urdherat e Ministrit te Drejtesise, por edhe sipas ligjit te ri, ky i fundit vepron mbi kerkesen e arsyetuar e cila duhet t’i paraqitet Ministrit nga **Drejtuessi i Prokurorise se Posacme**.

Prokuroria e Posacme per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar eshte krijuar ne daten **19 Dhjetor 2019**, kur tetë prokurorë të emëruar në SPAK jane betuar para Presidentit të Republikës se Shqiperise.

Ne rastin e te dy Urdherave te Ministrit te Drejtesise, kerkesa dhe inicimi i procedures eshte bere nga Drejtuesja e Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda, e kallzuara **Donika Prela, e cila nuk e kishte kompetencen per te inicuar nje procedure te tille**.

E kallzuara Donika Prela, e mbeshtet kerkesen e saj ne Udhezimin Nr.2, date 24.05.2019 te Prokurorit te Pergjithshem te Perkoheshem ne ate kohe, te kallzuares Arta Marku.

E kallzuara Arta Marku, **ne kundersiztim me permbushjen e rregullt te detyres nga ana e saj, ne shkelje te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise**, ka nxjerre Udhezimin Nr.02, date 24.05.2019 “ Per zbatimin e ligjit lidhur me Regjimin e Posacem ne Burgun e Sigurise se Larte”, me te cilin udhezoon:

Neni 1

Kompetencat e drejtuesit te Prokurorise per Krime te Renda ne periudhen kalimtare.

- 1. Drejtuesi i Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda (ne vijim drejtuesi i PKR), deri ne momentin e krijimit te Prokurorise se Posacme, ne rastet e vecanta sipas kriterëve te percaktuara ne ligj, pas konsultimit me Ministrin e Brendeshem, bazuar ne te dhenat/informacionet e Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit, Sherbimit Informativ Shteteror, Drejtorit te Pergjithshem te Burgjeve dhe organeve te specializuara ne luften kunder krimin te organizuar e terrorizmit, me kerkesë te arsyetuar i kerkon Ministrit te Drejtesise vendosjen e te denuarit ose te paraburgosurit ne regjimin e posacem ne burgun e sigurise se larte.*

E kallzuara Arta Marku, ne funksionin e saj si Prokurore e Pergjithshme e Perkoheshme, ka shkelur Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, duke nxjerre nje udhezim ne kundersiztim me sa urdheron ligji nr 108/2018 “Per nje shtese ne Ligjin Nr.8328, date 16.04.1998 “Per te drejttat dhe trajtimin e te denuarve me burgim dhe te te paraburgosurve”.

Sipas ligjit te sipercituar, nenit 13/1 te tij, Ministri i Drejtesise, vendos mbi kerkesen e arsyetuar te Drejtuesit te Prokurorise se Posacme.

Neni 13/1

Regjimi i posaçëm në burgun e sigurisë së lartë

*2. Vendimi për vendosjen e të dënuarit ose të paraburgosurit në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë merret nga Ministri i Drejtësisë mbi kërkesën e arsyetuar të **Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme**, pas konsultimit me Ministrin e Brendshëm, bazuar në të dhënat/informacionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe organeve të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, sipas fushave të përgjegjesisë.*

Po çfare thote Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë? Po percjellim ketu me poshte dispozitat e neneve 116,117,118,119 dhe 120 te Kushtetutes te vendosura ne Pjesen e Shtate, te titulluar Aktet Normative dhe Marreveshjet Nderkombetare:

KREU I

AKTET NORMATIVE

Neni 116

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:
 - a) Kushtetuta;
 - b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
 - c) ligjet;
 - ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.
2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.
3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.

Neni 117

1. Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.
2. Shpallja dhe botimi i akteve të tjera normative bëhet sipas mënyrës së parashikuar me ligj.
3. Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit.

Neni 118

1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.
2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.
3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë

kompetencën e tij një organi tjetër.

Neni 119

1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre.
2. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera.
3. Rregulloret dhe urdhrat nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme.

Neni 120

Parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj.

Neni 118 i Kushtetutes se Republikes e percakton fare qarte se aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë; se Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte; se Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.

Ish Prokurorja e Pergjithshme e Perkoheshme, e kallzuara Arta Marku, ne kundërshtim flagrant me ligjin dhe Kushtetuten e Republikës, ka nxjerrë një akt, pa qene e autorizuar nga ligji, pa iu deleguar kjo kompetence nga një organ i autorizuar nga ligji, duke tejkaluar cdo kompetence dhe duke cenuar haptazi funksionimin e shtetit ligjor.

Edhe nga referencat që ka vendosur në bazë të Udhëzimit të Pergjithshëm nr.02, datë 24.05.2019, e kallzuara Arta Marku, rezulton se kjo e fundit ka vepruar në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës nga ana e saj.

Konkretisht, duke iu referuar dispozitës së nenit 148 pika 1 të Kushtetutes, sipas së ciles “*Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.*”, nuk rezulton që ligji të ketë ngarkuar Prokurores të Pergjithshme të Perkoheshme detyrën që të zëvendësojë Kuvendin e Shqipërisë dhe t’i shtojë një ligji dispozita kalimtare sikunder ka vepruar në rastin konkret!

Se dyti, neni 148 shkronja “b” e Kushtetutes parashikon: “*Prokurori i Pergjithshëm ushtron këto kompetenca: b) nxjerr udhëzime të pergjithshme me shkrim për prokuroret, me përjashtim të Prokurorisë së Posacme*”. Pra Prokurori i Pergjithshëm nuk mund të nderhyjë në kompetencat e Prokurorisë së Posacme!

Se treti, Neni 38 pika 2 shkronja b e ligjit 97/2016 parashikon: “*2.Prokurori i Pergjithshëm ushtron këto kompetenca: b) nxjerr udhëzime të pergjithshme me shkrim për prokuroret e prokurorisë të juridiksionit të pergjithshëm dhe mbikqyr zbatimin e tyre.*” Edhe në këtë rast Prokurori i Pergjithshëm i Perkoheshëm ka pranuar se mund ta ushtrojë

kompetencen e tij vetem persa i perket prokurorive te juridiksionit te zakonshem!

Te gjitha referencat e tjera qe ka vendosur ne Udhezimin e Pergjithshem, bejne fjale per kompetencat e prokurorise per te ushtruar ndjekjen penale dhe perfaqsimin e ceshtjes ne gjyq nga prokuroret e krimeve te renda deri ne krijimin e Prokurorise se Posacme dhe jo per kompetenca qe burojne nga ligje te vecanta te tjera, sikunder eshte ajo e percaktuar ne ligjin nr.108/2018 "Per nje shtese ne Ligjin Nr.8328, date 16.04.1998 "Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim dhe te te paraburgosurve". Por jo vetem me referencat ligjore ne baze te te cilave ka nxjerre Udhezimin e Pergjithshem, por edhe ne arsyen ligjore ne te cilen e mbeshtet nxjerrjen e tij, Prokurorja e Pergjithshme e Perkoheshme, e kallzuara Arta Marku, eshte sforcuar te justifikojte shkeljen e ligjit dhe te Kushtetutes, kur shprehet:

"Me synim, unifikimin e zbatimit te ligjit lidhur me regjimin e posacem ne burgun e sigurise se larte per te garantuar ruajtjen e rendit dhe te sigurise ne keto institucione te ekzekutimit te vendimeve penale (IEVP) dhe/ose rritjen e efektivitetit ne parandalimin e komunikimit te denuarve apo te paraburgosurve me organizaten kriminale ku bejne pjese apo me organizata kriminale te tjera".

Nderkohe, nuk ka filluar ende zbatimi i ligjit qe te beje te nevojeshme unifikimin e praktikes inekzistente deri ne ate moment, sikunder Prokurori i Pergjithshem i Perkoheshem, nuk e shtrin autoritetin e tij tek Prokuroria e Posacme, por vetem tek prokurorite e juridiksionit te zakonshem.

Ne rrethanat e siperpermendura, e kallzuara **Arta Marku**, duke qene ne funksionin e Prokurores se Pergjithshme te Perkoheshme, ka konsumuar elementet e vepres penale te "Shperdorimit te detyres", te parashikuar nga dispozita e nenit 248 te Kodit Penal, pasi me shkeljet e saj te ligjit ka cenuar funksionimin e rregullt te shtetit ligjor por edhe te drejtat tona te garantuara nga Kushtetuta dhe Aktet Nderkombetare te ratifikuara nga Kuvendi i Shqiperise.

Veprimet e mesiperme te te kallzuares **Arta Marku**, ne funksionin e Prokurores se Pergjithshme te Perkoheshme perbejne vepren penale te "Shperdorimit te detyres", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, sipas te cilit:

"Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a mosveprimeve ne kundërshtim me ligjin, qe perben mospermbushje te rregullt te detyres, nga personi qe ushtron funksione publikea kane demtuar interesat e ligjshem te shtetit, shtetasve..... denohet"

Objekt i vepres penale jane pikerisht marrëdhëniet juridike te vendosura nga Kushtetuta dhe Ligji per te siguruar veprimtarine normale te organeve shteterore apo per te mbrojtur interesat e ligjshem te shtetasve.

Nga ana objektive e kallzuara **Arta Marku** ne funksionin e Prokurores se Pergjithshme te Perkoheshme, duke shfrytezuar nje kompetence qe rrjedh

nga ligji organik per Prokurorine, duke nxjerre akte qe bijen ndesh me Kushtetuten dhe Ligjin, sic eshte edhe Udhezimi i Pergjithshem Nr.02, date 24.05.2019, ne kundersiztim me permbushjen e rregullt te detyres nga ana e saj, me kete veprim ka cenuar veprimtarine normale te oganeve shteterore ne nje shtet ligjor demokratik qe ka sjhelle vec kesaj dhe pasoja per te drejttat tona te garantuara nga Kushtetuta dhe Ligji.

Si subjekt i vepres penale e kallezuara **Arta Marku**, i permbush plotesisht kriteret ligjore. Ajo ne detyren e saj si Prokurore e Pergjithshme e Perkoheshme ka vepruar ne kundersiztim me detyrimet e saja ligjore dhe kushtetuese per te permbushur ne menyre te rregullt detyren, njekohesisht ajo eshte pergjegjshme.

Nga ana subjektive e kallzuara **Arta Marku**, ne funksionin e Prokurores se Pergjithshme te Perkoheshme, ne perfundim te mandatit te saj te tejzgjatur, i ka kryer me dashje direkte veprimet dhe mosveprimet e saja duke sjelle pasoja te drejtperdrejta ndaj nesh dhe ndaj funksionimit te rregullt te shtetit ligjor.

E kallzuara tjeter **Donika Prela**, duke qene ne detyren e Drejtueses se Prokurorise se Krimeve te Renda, ne kundersiztim me permbushjen e rregullt te detyres nga ana e saj, qe kerkon respektim rigoroz te Kushtetutes dhe Ligjit, ka inicuar proceduren per aplikimin ndaj nesh, Emiljano Shullazit dhe Gilmando Danit, te regjimit te posacem ne burgun e sigurise se larte prane IEVP „Jordan Misja“ Ttirane, me kerkesat me Nr.166 Prot., date 01.11.2019 (*per Emiljano Shullazin*) dhe Nr.171 Prot., date 01.11.2019 (*per Gilmando Danin*) drejtuar Ministrit te Drejtesise, duke marre nje kompetence ligjore qe i takonte Drejtuesit te Prokurorise se Posacme, qe ne ate kohe nuk ishte krijuar ende.

Sikunder e shpjeguam me lart ne kete kallzim, e kallzuara **Donika Prela**, ka shfrytezuar Udhezimin e Pergjithshem te ish Prokurores se Pergjithshme te Perkoheshme Arta Marku, per te inicuar ne menyre te paligjshme nje procedure qe nuk i takonte.

Qe ne nenin 4 te saj, Kushtetuta e Republikes se Shqiperise percakton se shteti shqiptar e mbeshtet veprimtarine e tij vetem ne te drejten, pra ne respektimin e Kushtetutes se ligji me i larte ne Republikën e Shqiperise dhe ligjet e tjera qe dalin ne baze te saj.

Kushtetuta e republikes percakton gjithashtu se dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpersedrejti pervec rasteve, kur vete Kushtetuta e percakton ndryshe.

E kallzuara **Donika Prela**, duke qene e ndergjegjshme se sipas ligjit nr 108/2018 “Per nje shtese ne Ligjin Nr.8328, date 16.041998 “Per te drejttat dhe trajtimin e te denuarve me burgim dhe te te paraburgosurve”, nenit 13/1 te tij, nuk ishte ne kompetencen e saj te iniconte proceduren per vendosjen tone ne regjimin e sigurise se larte, por ishte ne kompetencen e Drejtuesit te Prokurorise se Posacme, e inicioi kete procedure duke e justifikuar veprimin e saj me Udhezimin e Pergjithshem Nr.02, date 24.05.2019, te Prokurores se Pergjithshme te Perkoheshme, te kallzuares tjeter **Arta Marku**, pra duke zbatuar nje akt te kundraligjshem,

qe binte ndesh me Kushtetuten dhe ligjin ne baze te te cilit pretendonte se ishte nxjerre.

Neni 4

1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.
2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.
3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Analizen për kundraligjshmerine e Udhezimit të Përgjithshëm, e kemi bërë me sipër dhe për të mos rënë në perseritje, po vijojmë me veprimet e tjera të kryera nga e kallzuara **Donika Prela**.

Gjithçka përmbledhet në kërkesat që e kallzuara **Donika Prela** ka bërë kundër nesh, është:

1. *...Duke qenë me statusin e e personave të paraburgosur, në pritje të vendimit të formës së prerë, vazhdojmë të mbajmë dhe ushtrojmë veprimtari kriminale.....*
2. *„Ka dyshime se i pandehuri Emiljano Shullazi për shkak të faktit se ndodhet i kushtezuar nga takimet e drejtpërdrejta me të gjithë lidhjet e tij jashtë, për kryerjen e aktiviteteve të tij të paligjshme, përfshirë dhe për kanosje të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tirane, me qëllim për të ndikuar në vendimarrjen e tyre gjatë gjykimit të kërkesave të paleve në gjykimin që po zhvillohet në këtë gjykatën e apelit, aktivizon lidhjet e tij me të ngushta që ka në IEVP me të që janë Gilmando Dani, Endrit Zela, Endrit Qyqja dhe Blerim Shullazi“*
3. *„Rezulton se të gjithë pjestarët e grupit të strukturuar takohen me njëri tjetrin dhe konkretisht, Emiljano Shullazi, gjatë qëndrimit në ambientet e IEVP se si i paraburgosur frekuenton qelitë e të paraburgosurve të tjere që janë pjesë e grupit të strukturuar kriminal të drejtuar prej tij dhe me të cilët ka kryer veprat penale si Gilmando Dani, Blerim Shullazi, Endrit Zela dhe Endrit Qyqja. Po kështu nëpërmjet këtyre personave ka dyshime se i pandehuri Emiljano Shullazi realizon takime dhe me të paraburgosur të tjere pranë IEVP se si dhe ben transmetimin e urdherave jashtë ambienteve të IEVP se për kryerje veprimtarie kriminale të paligjshme“*
4. *„Si rezultat i takimeve me të shpeshta që anëtarët e tjere të grupit kanë mundësi të kryejnë me persona të tjere jashtë IEVP se nën emrin e Emiljano Shullazit transmetojnë urdhera tek lidhjet e tjera të cilët janë në rolin e zbatuesve të porosive të dhena“.*

Gjithë sa janë shkruar më lart nga e kallzuara Donika Prela, jo vetëm janë të paverteta dhe shpifje të padenja për një gardian burgu e jo me për një drejtuese prokurorie. Një prokuror nuk flet me fjale për dyshime por kryen veprime konkrete, nëse Emiljano Shullazi ka kërcënuar gjyqtarë, njihet një akuze për të, nëse ka dhënë dhe porosi nga burgu, tek ata që Donika Prela i quan bashkëpunetore dhe zbatues të porosive të kundraligjshme të Emiljano Shullazit, edhe këta vihen sebashku me Emiljanon nën akuze. Aktiviteti kriminal i pretenduar apo „i dyshuar“ sipas Donika Preles, pengohet duke kryer prokuroria detyrën e saj, duke vertetuar veprimet e kundraligjshme sipas kompetencës kushtetuese që ka për ushtrimin e

ndjekjes penale dhe jo me *thash e theme* qe sherbejne per qellime qe s'kane te bejne me drejtesine.

E kallzuara Donika Prela, pervec qe ka iniciuar nje procedure te kundraligjshme, pa qene kompetente, sikunder sqaruam me lart, duke shfrytezuar autoritetin e saj si drejtuese e Prokurorise per Krimet e Renda, ajo ka vene ne levizje Ministrin e Drejtesise duke shkaktuar se pari funksionimin jo te rregullt te sistemit ne nje shtet ligjor dhe se dyti duke dhunuar dhe shkelur ne menyre flagrante te drejtat tona kushtetuese dhe ligjore.

Veprimet e mesiperme te te kallzuares **Donika Prela**, ne funksionin e Drejtueses se Prokurorise se Krimeve te Renda perbejne vepren penale te "Shperdorimit te detyres", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, sipas te cilit:

"Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a mosveprimeve ne kundershtrim me ligjin, qe perben mospermbushje te rregullt te detyres, nga personi qe ushtron funksione publikea kane demtuar interesat e ligjshem te shtetit, shtetasve..... denohet"

Objekt i vepres penale jane pikerisht marredheniet juridike te vendosura nga Kushtetuta dhe Ligji per te siguruar veprimtarine normale te organeve shteterore apo per te mbrojtur interesat e ligjshem te shtetasve.

Nga ana objektive e kallzuara **Donika Prela** ne funksionin e Drejtueses se Prokurorise se Krimeve te Renda, duke shfrytezuar funksionin e saj ka iniciuar nje procedure te kundraligjshme, bazuar ne nje akt te kundraligjshem dhe ka shtremberuar realitetin ne kerkesen drejtuar Ministrit te Drejtesise, ne kundershtrim me permbushjen e rregullt te detyres nga ana e saj, me kete veprim ka cenuar veprimtarine normale te organeve shteterore ne nje shtet ligjor demokratik qe ka sjelle vec kesaj dhe pasoja per te drejtat tona te garantuara nga Kushtetuta dhe Ligji.

Si subjekt i vepres penale e kallezuara **Donika Prela**, i permbush plotesisht kriteret ligjore. Ajo ne detyren e saj si Drejtuese e Prokurorise se Krimeve te Renda ka vepruar ne kundershtrim me detyrimet e saja ligjore dhe kushtetuese per te permbushur ne menyre te rregullt detyren, njekohesisht ajo eshte pergjegjshme para ligjit.

Nga ana subjektive e kallzuara **Donika Prela**, ne funksionin e Drejtueses se Prokurorise se Krimeve te Renda, ne perfundim te mandatit te saj si drejtuese, per qellime karrieriste dhe jo te ligjshme, i ka kryer me dashje direkte veprimet dhe mosveprimet e saja duke sjelle pasoja te drejtperdrejta ndaj nesh dhe ndaj funksionimit te rregullt te shtetit ligjor.

Z/Znj. Prokuror/e i Prokurorise se Posacme,

Kerkojme regjistrimin e ketij kallzimi dhe kryerjen e veprimeve hetimore qe do te vertetojne pretendimet tona lidhur me veprimet e

kundraligjshme te kryera nga ish Prokurorja e Pergjithshme e Perkoheshme Arta Marku dhe Ish Drejtuesja e Prokurorise per Krimet e Renda, Donika Prela dhe fillimin e procedimit penal ndaj tyre per kryerjen e vepres penale te „ Shperdorimit te detyres“, te parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

KALLEZUESIT

Emiljano Shullazi

Gilmando Dani

IEVP „ Jordan Misja” - Regjimi i Posacem i Sigurise se Larte, Tirane.